

V E N D I M
Nr.589, datë 16.10.1995

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET DHE
PËRCAKTIMIN E QIRASË PËR OBJEKTET SHTETËRORE QË U JEPEN NË PËRDORIM
TË TRETËVE**

Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimëtarive private të pavarura dhe privatizimit", me qëllim të përmirësimit të procedurave të vlerësimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme që do të privatizohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për vlerësimin e elementeve të pasurisë dhe kompetencat.
2. Për ndërtesat dhe ndërtimet vlera aktuale minimale (VAM-i) llogaritet duke korrigjuar vlerën kontabël të mbetur me koeficientin e indeksit 5,4 dhe me vendndodhjen sipas pasqyrës së bashkëlidhur.

Vlera kontabël e mbetur përcaktohet, për çdo ndërtesë ose ndërtim tjetër që figuron si njësi e veçantë në inventarin e ndërmarrjes, duke zbritur nga vlera kontabël bruto (fillestare) shumën e amortizimit të llogaritur në bazë të viteve të qenies në përdorim dhe të normës vjetore të konsumit që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 23.10.1989, pjesa "Amortizimi për investimet".

Vlera aktuale minimale për ndërtesat dhe ndërtimet pas vitit të liberalizimit të çmimeve (korrik 1992) do të jetë e barabartë me vlerën kontabël të mbetur të korrigjuar me koeficientin e indeksit që del nga raporti ndërmjet dy koeficientëve (të vlerësimit ndaj saj të ndërtimit ose vënies në shfrytëzim), si dhe me shtesat ose pakësimet për vendndodhjen sipas pasqyrës përkatëse.

Nëse vlera aktuale minimale që del nga llogaritjet e mësipërme duket jobindëse, atëherë me dy apo më shumë ekspertë të kërkuar nga komisioni i vlerësimit, të bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast do të zgjidhet vlera aktuale minimale që duket më e përafërt ndaj gjendjes reale të objektit.

Përcaktimi i vlerës aktuale minimale nga dy a më shumë ekspertë do të bëhet për rastet:

- Kur mungojnë të dhënat për vjetërsinë e objektit dhe për vlerën kontabël bruto ose kur këto të dhëna i referohen një tërësie tjetër, nga e cila është veçuar objekti që kërkohet të vlerësohet. Në këtë rast grupi i ekspertëve duhet të bëjë vlerësimin e objektit me çmime të manualit 1986-1990, duke zbritur amortizimin përkatës.

Kur mungon edhe viti i vënies në shfrytëzim, grupi i ekspertëve gjykon vetë për amortizimin.

Mbi këtë vlerë të mbetur zbatohet koeficienti i indeksit 5,4, si dhe koeficienti i vendndodhjes.

- Kur objekti ka dëmtime fizike ose mungesa pjesësh e instalimesh organike që cenojnë funksionimin e tij, grupi i ekspertëve që në fillim zbrit nga vlera fillestare e objektit vlerën fillestare të mungesave ose dëmtimeve. Vlerës fillestare (duke zbritur mungesat) i zbritet amortizimi përkatës dhe zbatohet koeficienti i indeksit 5,4, si dhe koeficienti i vendndodhjes.

Për të gjitha rastet raporti i ekspertëve miratohet nga komisioni i vlerësimit.

2. Për makineritë dhe pajisjet vlera aktuale minimale përcaktohet në bazë të vlerës kontabël të mbetur e korrigjuar me koeficientin e indeksit 5,4.

Vlera kontabël e mbetur përcaktohet, për çdo makineri ose pajisje që përbën njësi inventari të veçantë, duke zbritur nga vlera kontabël bruto shumën e amortizimit që i përgjigjet shkallës së konsumit për shkak të përdorimit.

Shuma e amortizimit do të llogaritet në bazë të viteve të përdorimit dhe normave të amortizimit vjetor për investime që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 23.10.1989.

Për makineritë dhe pajisjet të prodhuara ose të blera pas vitit të liberalizimit të çmimeve (korrik 1992) VAM-i do të përcaktohet njëllëj si për ndërtimet, por pa zbatuar shtesat ose pakësimet për vendndodhjen.

Vlera aktuale minimale do të përcaktohet nga dy a më shumë ekspertë për rastet që vijojnë:

- Kur vlera aktuale minimale e përcaktuar në bazë të të dhënave kontabël gjykohet se nuk i përgjigjet gjendjes reale të makinerisë a të pajisjes së dhënë.

- Kur të dhënat kontabël në ndërmarrje mungojnë ose nuk janë të rregullta.

- Kur makinerisë a pajisjes i mungojnë pjesë ose nyje që cenojnë funksionimin ose ka dëmtime që duhen ndrequr.

Për këto raste grupi i ekspertëve përpilon raportin e vlerësimit dhe vepron njëllë si grupi i ekspertëve për ndërtimet, por pa zbatuar koeficientin e indeksit 5,4 dhe të vendndodhjes.

Pas vitit 1995 korrigjimi i vlerës kontabël të mbetur për të marrë parasysh ndryshimin e çmimeve vjetore për ndërtimet dhe makineritë e pajisjet do të bëhen me koeficientin e indeksit vjetor të konsumit të miratuar nga Instituti i Statistikës.

3. Për mjetet dhe mekanizmat e transportit të blera para korrikut 1992, vlera aktuale minimale përcaktohet nga dy a më shumë ekspertë, në bazë të çmimeve të tregut dhe gjendjes teknike të mjetit sipas raportit teknik përkatës, të miratuar nga komisioni i vlerësimit. Për mjetet dhe mekanizmat e transportit të blera gjatë vitit 1992 e në vazhdim, vlerësimi do të bëhet duke u nisur nga çmimi i blerjes minus shumën e amortizimit për vitet e përdorimit pas vitit të blerjes. Kësaj shume i zbritet edhe vlera e dëmtimeve të rënda për raste avarie, karamboli etj., të vërtetuara me aktin përkatës nga dy a më shumë ekspertë. VAM-i i përcaktuar në këtë mënyrë miratohet nga komisioni i vlerësimit.

4. Për inventarin ekonomik, instrumentet e veglat e punës dhe elemente të tjerë që figurojnë në përbërje të aktiveve të qëndrueshme (mjete kryesore) të ndërmarrjes, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në bazë të vlerës kontabël të mbetur. Vlera kontabël e mbetur përcaktohet për çdo njësi inventari, duke zbritur nga vlera kontabël bruto, shumën e amortizimit që i përgjigjet shkallës së konsumit për shkak të përdorimit.

5. Për kafshët e punës dhe të prodhimit, si dhe për gjënë e gjallë në rritje e majmëri. Vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit në bazë të çmimeve të tregut, duke mbajtur parasysh edhe gjendjen e vlerën zooteknike.

6. Për kulturat drufrutore, ullinjë, vreshtat në prodhim ose në rritje, vlera aktuale minimale përcaktohet nga një komision vlerësimi në bazë të llogaritjes së vlerës kontabël të regjistruar dhe duke zbritur kur është rasti amortizime të pësura.

Për rastet e mungesave ose dëmtimeve komisioni ose grupi i ekspertëve të veprojnë si në rastin për ndërtimet. Për këtë grup vlera e mbetur nuk do të indeksohet.

7. Vlerësimi i mjeteve të xhiros që janë gjendje e materializuar bëhet me këtë mënyrë:

Komisioni i vlerësimit i ndan mjetet e xhiros në 3 grupe:

a) Në artikujt që kanë vlera tregtimi me qarkullim normal.

b) Në artikujt që kanë vlera tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm.

c) Artikujt që nuk gjejnë treg shitjeje.

Artikujt e grupit “a” do të vlerësohen me vlerë aktuale kontabël por në asnjë rast nuk duhet të kalojë vlerën aktuale të shitjes me shumicë në tregun aktual.

Artikujt e grupit “b” do të vlerësohen me vlerën kontabël të kohës së blerjes së artikullit ose të përgatitjes së produktit të gatshëm për shitje, por në asnjë rast nuk duhet të kalojë vlerën aktuale minimale të shitjes me shumicë në tregun aktual.

Artikujt e grupit “c” do të vlerësohen me vlerën kontabël të kohës, kur janë futur gjendje në ndërmarrje të shumëzuar me koeficientin 0,1.

Në rastet kur ka elemente pasurie pa vlerë përdorimi a të zhvlerësuar, do të procedohet në nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit ose në uljen e vlerës.

Nxjerrja jashtë përdorimit do të kryhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993.

Ulja e vlerës do të kryhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e dy apo më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

Nxjerrja jashtë përdorimit miratohet sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993, kurse ulja e vlerave miratohet nga këshilli drejtues i ndërmarrjes.

Vlera e nxjerrë nga komisioni i vlerësimit ditën e mbylljes së vlerësimit, si rezultat i shumës së tri vlerave të sipërpërmendura, do të përfaqësojë vlerën aktuale minimale të mjeteve të xhiros në momentin e shitjes për ndërmarrjet me veprimari të bllokuar në intervalin e kohës vlerësimi shitje.

Për ndërmarrjet që vazhdojnë veprimëtarinë gjatë intervalit vlerësimi-shitje, blerjet pas vlerësimit të pasqyrohen në kartela të reja, kurse shitjet në kartelat ekzistuese. Në këtë rast i jepet e

drejta likuidatorit që për artikujt e rinj të grupit “a” me grup ekspertësh të bëjë vlerësimin e tyre sipas çmimeve aktuale të tregut me shumicë.

Për të tjerët qëndron në fuqi mënyra e sipërpërmendur e vlerësimit.

8. Vlerësimi i detyrimeve të ndihmave shtetërore që krijojnë fond kundërparti, të bëhet sipas kritereve të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.10.1994 dhe nr.55, datë 30.1.1995, e të udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tyre dhe në pasqyrën nr.3 të pasqyrohen zë më vete, pasi pagesa e tyre do të bëhet në lekë.

9. Kur për objektet e shpallura për shitje sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme”, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë Agjencia Kombëtare e Privatizimit e degët e saj në rrethe caktojnë një VAM tjetër më të ulët që të joshë kandidatët për privatizimin e objektit. Ulja e VAM-it të këtyre objekteve të bëhet sipas kategorive të rretheve dhe vetëm për mjetet kryesore:

Për rrethet e kategorisë I deri në 20 për qind

Për rrethet e kategorisë II deri në 40 për qind

Për rrethet e kategorisë III deri në 60 për qind

Në këto raste objekti kalon edhe një herë në të gjitha procedurat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995.

Ish-pronari i truallit këto objekte i blen me vlef të fillestare. Për rastet kur blerësit mbeten vetëm një bëhet për 10 ditë një njoftim i ri në gazetën nacionale dhe një në gazetën lokale, ku përcaktohen të dhënat e objektit. Nëse edhe pas këtij njoftimi nuk paraqitet kandidat për blerjen e objektit, atëherë dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit bën shitjen e objektit kandidatit të vetëm.

II. Për detyrimet debitore dhe kreditore.

Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen mbyllen në momentin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen e debi-kredive nga dita e shpalljes së ndryshimit të pronës shtetërore.

Për detyrimet debitore dhe kreditore veprohet si vijon:

1. Kur bëhet privatizimi i gjithë ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitore dhe kreditore i kalojnë shtetit. Organi nga varet ndërmarrja (ministria ose organi i pushtetit lokal) ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar ose një profesionist të lirë në bazë të një kontrate të posaçme për ndjekjen e arkëtimit. Këta kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 deri në 10 për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 paga bazë sa të përgjegjësit të financës në këshillin e bashkisë. Ky shpërblim reduktohet deri në zero në qoftë se nuk zbatohet kontrata. Kjo kontratë të jetë e vlefshme deri në 1 vit dhe pas kësaj veprohet në bazë të ligjit nr.7631, datë 29.10.1992 “Për falimentimin e ndërmarrjeve”.

2. Kur bëhet privatizimi i pjesëshëm i ndërmarrjes shtetërore detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjes i kalojnë për ndjekje administratës për pjesën që mbetet shtetërore.

3. Likuidimi i detyrimeve të mbetura për fondin kundërparti të ndihmave shtetërore bëhet sipas kritereve të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.10.1994 dhe nr.55, datë 30.1.1995, e të udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. Për përcaktimin e qirasë aktuale minimale të objekteve shtetërore që u jepen në përdorim të tretëve.

Qiraja aktuale minimale vjetore për objektet e ndërmarrjeve ose institucioneve shtetërore që u jepen në përdorim të tretëve përcaktohet duke u bazuar në VAM-in, sipas kapitullit I të këtij vendimi. Qiraja aktuale minimale vjetore merret sa VAM-i i objektit e pjesëtuar me vitet e mbetura deri në amortizimin e plotë të objektit. Kur objekti është i përbërë nga disa elemente, të llogaritet qiraja minimale për çdo objekt dhe shuma e tyre përbën qiranë minimale të objektit në tërësi. Nuk lejohet lidhja e kontratës nën qiranë minimale dhe për rastet mbi vlerën e qirasë minimale vendosin organet kompetente.

IV. Detyra e të drejta të përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

1. Në zbatim të pikës 6 të kapitullit I të këtij vendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për të hartuar kriteret e rivlerësimit për kulturat drusore, frutore, vreshtat e ullishtet në prodhim a në rritje brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore miratohet nga drejtori i ndërmarrjes ose institucionit ku kryhet vlerësimi i pasurisë shtetërore. Në komision do të bëjë pjesë detyrimisht kryetari i degës së financës ose përgjegjësi i llogarisë së ndërmarrjes dhe kryesohet nga drejtori a

zëvendësi i tij.

Në ndihmë të komisionit, për caktimin sa më drejt e real të vlerësimit, veç pjesëtarëve të komisionit aktivizohen edhe ekspertë të fushave të ndryshme sipas kërkesës së ndërmarrjes ose institucionit. Këshilli i rrethit, i bashkisë ose ministria përkatëse duhet të ketë miratuar listën e ekspertëve të fushave të ndryshme.

Anëtarët e komisionit për periudhën e vlerësimit të pronës shtetërore përfitojnë një pagesë suplementare mbi bazë. Shpenzimet për këto pagesa kryhen dhe evidentohen nga ndërmarrja ose institucioni që kryen vlerësimin e pasurisë.

Masa e shpërblimit mbi pagën bazë të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të pasurisë shtetërore do të jetë:

a) Anëtarët e komisionit që janë punonjës të ndërmarrjes ose institucionit përfitojnë fillimisht një shtesë 20 për qind mbi pagën bazë që kanë pasur. Këtë masë shpërblimi e përfitonë edhe drejtori i ndërmarrjes a institucionit, pavarësisht nëse është anëtar i këtij komisioni.

b) Përfaqësuesit ekspertë të vlerësimit të pasurisë shtetërore përfitojnë një shtesë fillestare 30 për qind mbi pagën bazë, për ditët e pjesëmarrjes në vlerësim.

Ditët e pjesëmarrjes në vlerësimin e objektit përcaktohen nga data e fillimit të vlerësimit theksuar në dokumentin e miratimit të komisionit deri në datën e dërgimit të vlerësimit të pasurisë nga ndërmarrja ose institucioni në organet e privatizimit.

Komisioni i vlerësimit të pasurisë shtetërore mban përgjegjësi ligjore për saktësinë e veprimeve të kryera.

3. Vlera e fillimit të ankandit do të jetë vlera e VAM-it, përcaktuar sipas kapitullit I të këtij vendimi (mjete kryesore + mjete xhiroje). Ankandi do të zhvillohet vetëm për mjetet kryesore dhe vlefte e mjeteve të xhiros do të shtohet sipas inventarit fizik në momentin e dorëzimit të objektit.

4. Në rastet kur ndërmarrja privatizohet totalisht, zbatohet procedura e likuidimit nën drejtimin e një personi të emëruar me cilësinë e likuidatorit, i cili merr të drejtat e detyrat e përcaktuara për drejtorin dhe këshillin drejtues të ndërmarrjes.

Likuidatori emërohet nga organi i emërtesës me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe të degëve të saj në rrethe. Përjashtimisht për ndërmarrjet që ka pasë mbuluar ish-AQRP e NB-ve, likuidatori do të emërohet nga drejtoria e bujqësisë në rreth, me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe të degëve të saj në rrethe.

Ai është i detyruar të përfundojë evidencimin me procesverbal të objektit që privatizohet brenda 45 ditëve nga data e dhënies së autorizimit blerësit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Procesverbali i evidencimit do të firmoset nga likuidatori, drejtori dhe nga fituesi i së drejtës së blerjes së objektit. Mbas pagesës së plotë të vlerës së objektit dhe lidhjes së kontratës së shitjes, procesverbali shërben si akt dorëzimi i ndërmarrjes.

Paga e likuidatorit është për 45 ditë me një shtesë 50 për qind më e lartë se e drejtorit të objektit që merr për likuidim. Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objekteve 45-ditëshi i dorëzimit do të zgjatet me autorizim të degëve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Nga shtesa e pagës së likuidatorit ulen vlefte e dëmit, derisa shtesa e pagës së dhënë të zbritet në zero, nëse gjatë periudhës së dorëzimit ndodhin vjedhje a dëmtime të tjera të pronës shtetërore që dorëzohet, pavarësisht nga përgjegjësia e likuidatorit.

5. Detyra e likuidatorit është dorëzimi i pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve që privatizohen sipas inventarit të kryer në momentin e vlerësimit të kësaj pasurie, duke evidencuar evidencat fizike të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të pasurisë që privatizohet, ndjekjen e këtyre diferencave duke vënë përpara përgjegjësisë ligjore personat përgjegjës në mbështetje të ligjeve në fuqi, si dhe përgatitjen e bilancit të likuidimit të kësaj pasurie shtetërore.

Likuidatori i objektit që privatizohet ka të drejtë të marrë specialistë ekspertë për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja ka vazhduar veprimëtarinë dhe kur vëren se ka mungesa fizike në njësitë inventariale.

Çdo blerës, para se të marrë pjesë në ankand, duhet ta inspektojë objektin që shitet, të njihet me vlerësimin e tij dhe të lëshojë deklaratë pajtueshmërie për gjendjen e objektit.

Gjithashtu ai ka të drejtë të asistojë edhe gjatë punës së likuidatorit ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

Në rastet kur ka diferenca fizike (mungesa) në pasurinë shtetërore që privatizohet sipas aktit të dorëzimit të mbajtur nga likuidatori me blerësin privat, në krahasim me inventarin fizik të vlerësimit,

blerësit i kthehet vlere e diferencave me urdhër të degës së agjencisë së privatizimit nga pagesa e kryer prej tij, në mbështetje të autorizimit të lëshuar nga kjo agjenci. Kjo diferencë vilet nga personat përgjegjës sipas dokumentacionit të zhdëmtimit të nxjerra nga likuidatori dhe dora-dorës derdhet në buxhet.

Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore nëpërmjet ankandit dhe ka diferenca fizike (mungesa) në dorëzimin e objektit, vlere e kthimit të diferencave do të jetë vlere e mungesave fizike të rezultateve sipas VAM-it shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit në krahasim me vlerën fillestare të fillimit të ankandit për objektin e shitur.

6. Sipas varësisë së ndërmarrjeve a institucioneve, drejtoritë ose seksionet e financave të ministrive apo organeve të pushtetit lokal kanë për detyrë lidhjen e kontratës me profesionistë ose financiarë të zgjedhur dhe me likuidatorin e ndërmarrjes ose të institucionit për ndjekjen e debikredive të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore që privatizohen.

7. Për rastet kur ndërmarrja nuk ka aftësi paguese, shpenzimet për pagat e komisionit të vlerësimit dhe likuidimit të përballohen nga organi nga varet ndërmarrja.

Në zbatim të këtij vendimi nuk do të përfshihen dokumentacionet e vlerësimit të objekteve të paraqitura për privatizim pranë degëve të shoqërive publike, agjencisë kombëtare të privatizimit dhe degëve të saj në rrethe para daljes së këtij vendimi.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që do të privatizohet ose vendoset në shoqëritë e përbashkëta, si dhe përcaktimi i qirasë së objekteve shtetërore që u jepen në përdorim të tretëve”, dhe udhëzimi përkatës nr.13, datë 20.5.1994, shfuqizohen, duke përjashtuar shtesat e tij për Ministrinë e Burimeve Minerare dhe Energetike. Po kështu shfuqizohen edhe të gjitha udhëzimet përkatëse në zbatim të tij, të cilat bien në kundërshtim me kriteret e vendosura në këtë vendim. Shfuqizohen edhe afatet e dërgimit të dokumentacionit të vlerësimit sipas pikave 6 e 8 të kapitullit IV të udhëzimit nr.3, datë 30.7.1992 “Për detyrat dhe të drejtat e nënkomisioneve të privatizimit, si dhe për mënyrën që do të ndiqet për kalimin e pronës shtetërore në pronësi private”.

Pjesë e këtij vendimi është edhe pasqyra bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Vendndodhja e objekteve të paluajtshme	Shtesa	Pakësime
a)Në rrethet ose qytetet Tiranë, berat, Durrës. Fier, Korç, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlor ose në qendrat e banuara turistike, ku përfshihen zonat e përcaktuara nga Vendimi i Këshilli i Ministrave 88 datë 1.3.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”		
-Zonat e thella malore jo turistike	-	30%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a)	15%	-
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a) përveç pjesëve që përfshihen më poshtë	50%	-
-Në rrugët kryesore dhe segmente rrugësh me trafik të dendur (Rr.K.S.Rr.T.D.) të qytetit të Fier, Lushnje, Berat, qendrat e banuara të përshkruara në pikën a	60%	-
-Në Rr.K.S.Rr.T.D. të qyteteve Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Sarandë.	70%	-
b)Në rrethet ose qytetet Delvinë, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Laç e Lezhë		
-Në zonat e thella malore jo turistike	-	50%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme	-	-

(pika b)		
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve (pika b)	35%	-
- Rr.K.S.Rr.T.D të qyteteve të pikës b	50%	-
c)Në rrethet ose qytetet e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, Përmetit dhe qytetet e qendrat e tjera me 10-20 mijë banorë		
-Në zonat e thella malore jo turistike	-	55%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)	-	20%
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)	-	-
- Rr.K.S.Rr.T.D në qytetet e qendrat (pikës c)	10%	-
d) Në rrethet ose qytetet Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tropojë e qendra të tjera nën 10 000 banorë		
-Në zonat e thella malore jo turistike	-	70%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	25%
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)	-	20%
- Rr.K.S.Rr.T.D në qytet e qendra (pika d)	-	15%
-Në zonat e pikave doganore	35%	-